

# Shqipëria drejt një tregu të lirë për energjitë e rinovueshme!

Në vlerësimin e tij të publikuar sot, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka evidentuar hapat e rëndësishëm që ka bërë Shqipëria drejt ndërtimit të një tregu të energjisë më konkurrues, transparent dhe të qëndrueshëm, duke u afruar gjithnjë e më shumë me standardet e Bashkimit Europian.

Miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut nga Enti Rregullator i Energjisë, është vlerësuar si një hap kyç për kalimin nga kontratat afatgjata me çmime fikse (PPA) në Kontrata për Diferencë (CfD) – një model që mbështet zhvillimin e energjive të rinovueshme përmes tregut të lirë.

Sipas këtij modeli:

- Prodhuesit do të shesin energjinë e tyre direkt në tregun ditor;
- Do të mbrohen nga luhatjet e çmimeve përmes mekanizmit të CfD: nëse çmimi bie, ata marrin diferencën; nëse çmimi rritet, e kthejnë mbrapsht fitimin shtesë.

Ky ndryshim pritet të forcojë besimin e investitorëve, rrisë likuiditetin në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) si dhe të përgatisë Shqipërinë për integrimin në tregun e brendshëm të energjisë të BE-së.

ERE do të përfundojë vlerësimin e parë të gatishmërisë së tregut brenda 6 muajve, duke hapur rrugën për konvertimin e plotë të kontratave ekzistuese në CfD.

Ky proces është zhvilluar me mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe me kontributin aktiv të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, i cili e sheh këtë si një model për vendet e tjera të rajonit që synojnë skema mbështetëse të bazuara në treg.

**Artikullin e plotë mund ta shfletoni në linkun:**

<https://www.energy-community.org/news/Energy-Community-News/2025/11/13a.html>